



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komuna Hore - Vranisht
Qarku Vlore

KONTRATE PER MBIKQYRJE PUNIMESH

E lidhur sot me date 30.10.2014 midis

1. **Komunes Hore Vranisht** e perfaqesuar nga kryetari z. **Simbol Pazaj** i quajtur "Investitor"

dhe

2. znj. **Natasha Myrtaj** per punimet e objektit "Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Hore – Vranisht, Komuna Vranisht".

Objekti i kesaj kontrate eshte mbikqyrja e punimeve te zbatimit tek objekti: "Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Hore – Vranisht, Komuna Vranisht" bazuar ne urdhrin nr. _____ dt. _____, 2014 te Kryetarit te Komunes Hore Vranisht.

Palet bien dakort me kushtet e meposhteme :

1. Mbikqyresi i punimeve pergjigjet per zbatimin pike per pike te kontrates se nenshkruar, per realizimin e fazave te ndryshme dhe respektimin e afatit dhe kosos se vepres
2. Mbikqyresi i punimeve pergjigjet per ndertimin e objektit ne perputhje me projektin dhe kushtet teknike te zbatimit ne fuqi, per mbikqyrjen dhe pershkrimin e zbatimit te projektit, cilesine e materialeve te perdorura qe te plotesojne kerkesat e objektit, si dhe per vendosjen ne veper te elementeve te parapergatitur.
3. Mbikqyresi i punimeve i njoftohet Zyres se Sherbimeve nga Investitori.
4. Te gjitha dokumentat e percaktuara ne nenin 8 te Ligjit "Per kontrollin dhe Disiplinimin e Ndertimeve", qe sipermarrsi do te depozitoje ne Degen e Infrastruktures, si dhe libri i kantierit duhet te jene te firmosura nga mbikqyresi i punimeve.
5. Mbikqyresi i punimeve gjate zbatimit te objektit ngarkohet t'i jap instruksione dhe urdhera me shkrim, sa here qe e sheh te nevojshme dhe sipermarresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit ka te drejte te bej me shkrim verejtjet e tij, lidhur me instruksionet dhe urdherat e mbikqyresit te punimeve.

NATASHA MYRTAJ
Celina
PROJEKTI DREJTIM
KOLAUDIM

6. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte qe me miratim te investitorit te jap urdhera me shkrim per ndryshimet qe ai sheh te arsyeshme se duhen bere gjate zbatimit te vepres. Ne raste urgjente mbikqyresi i punimeve mund te urdheroje me shrim zbatimin e menjehershem te ndryshimeve.
7. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te kerkoj largimin nga puna te drejtuesit te kantierit ose te punetoreve apo te specilisteve te vecante per mos bindje, paaftesi ose pakujdesi te renda.
8. Materialet qe do te perdoren ne veper duhet te jene ne perputhje me kerkesat e kontrates. Ato mund te perdoren ne veper vetem me miratimin e mbikqyresit te punimeve. Materialet e ardhura ne kantier qe nuk pranohen nga Mbikqyresi i punimeve zevendesohen me te tjera me shpenzimet e sipermarresit.
9. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te vendose te beje prova te materialeve per te verifikuar cilesine e tyre. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermarresit.
10. Kur mbikqyresi i punimeve mendon se ka defekte ne konstruksione apo pjese te tjera te vepres, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejten mbikqyresit te punimeve, shpenzimet jane ne ngarkim te sipermarresit, ne rast te kundert sipermarresi ka te drejte te kerkoj shlyerjen e shpenzimeve.
11. Kur urdherohet nga mbikqyresi i punimeve, Sipermarresi duhet te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e veta, punimet e bera jo me clesine e parashikuar ose me materiale sipas pershkrimeve te projektit te standarteve ne fuqi.
12. Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohsisht punimet kur gjykon se ka shkaqe te arsyeshme per kete. Kjo nderprerje nuk duhet te zgjate me shume se 1/3 e kohezgjatjes se punimeve, sipas kontrates se nenshkruar, por ne cdo rast jo me shume se gjashte muaj.
13. Kur investitori lejon shmangie ne permasa ose cilesi, mbikqyresi i punimeve gjithmone ne rast se vepra eshte e pranueshme, duhet te zbatoj nje zbritje te cmimeve si kontabilitet dhe si vleresim perfundimtar ne kolaudim.
14. Sipermarresi duhet t'i njoftoj me shkrim Mbikqyresit te punimeve per perfundimin e punimeve. Me kete rast a i paraqet Mbikqyresit te punimeve:
 - a) Kontraten dhe aktet qe lidhen me te.
 - b) Regjistrimin e kontabilitetit
 - c) Proces -verbalet e dhenies, nderprerjes, zgjatjes para dhe mbas perfundimit te punimeve.
 - d) Kerkesa e tij.
15. Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqes investitorit materialet e sipershenuara te dorezuara nga sipermarresi se bashku me relacionin e vet.
16. Me perfundimin e punimeve brenda 30 diteve Mbikqyresi i punimeve duhet te depozitoje ne Drejtorine e Urbanistikes ne rreth nje relacion ne dy kopje, rreth zbatimit te punimeve me karakteristikat dhe cilesine e materialeve duke paraqitur:

NATASHA MYRTAJ
PROJEKTI DREJTIM
KOLAUDIM

- a) Çertifikaten e provave te materialeve te perdorura nga labororet e autorizuar per kete qellim.
 - b) Per ndertimet e paranderura çdo te dhene per plotesimin ne veper te kesaj strukture.
 - c) Perfundimet e provave eventuale ne ngarkese duke bashkelidhur aktet e mbajtura per kete qellim.
 - d) Deklarate qe objekti eshte zbatuar ne perputhje me projekt – zbatimin.
- Njera nga dy kopjet e konfirmuara nga Mbikqyresi i punimeve i dergohet kolaudatorit.

17. Mbikqyresi i punimeve asiston ne kolaudimin e vepres, i pergjigjet kolaudatorit per gjithe dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te vepres dhe firmos process-verbalin e kolaudimit

18. Mbikqyresi i punimeve eshte pergjegjes per fondin e vepres se tij, situacionet e paraqitura nga sipermarrsi pas kryerjes se punimeve ne faza te ndryshme mund te paguhet nga banka vetem pasi te jete shqyrtuar dhe firmosur nga Mbikqyresi.

19. Mbikqyresi i punimeve nuk duhet te kete lidhje pune, gjaku apo interesash me sipermarrsin dhe as me kolaudatorin net e kundert ai nuk ka asnje pengese te ketij lloji me projektuesin. Kjo behet me ane te nje deklarate me shkrim qe mbikqyresi i ben investitorit.

20. Kur verehen shkelje te dispozitave ligjore, investitori ka te drejte te urdheroje mbikqyrsin per pezullimin e punimeve.

21. Kur shkeljet e dispozitave ligjore nuk perbejne veper penale denohen me gjobe nga 1000 deri ne 10 000 leke, sipas ligjit "Per Kontrollin e Disiplinimin e Ndertimeve "Ne rast se mbikqyrsi kryen shkelje financiare dhe penalitete pergjigjet para ligjeve ne fuqi

22. Mbikqyresi i punimeve per kohen e punes qe eshte ne dispozicion te investitorit, paguhet prej tij me shumen 196 000 (njqind e nentedhete e gjashte mije) leke pa tvsh.

22. Per çdo mosmarrveshje palet duhet t'i drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore per zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve.

23. Kjo kontrate behet ne pese kopje, nga te cilat nje mban mbikqyresi, dy kopje investitori, nje kopje Drejtoria e Infrastruktures dhe Sherbimeve Publike dhe nje kopje sipermarrsi i punimeve.

24. Kjo kontrate ka bashkelidhur dokumentacionin e paraqitur nga mbikqyresi.

MBIKQYRESI I PUNIMEVE

INVESTITORI

KRYETARI

Simbol PAZAJ

Natasha MYRTAJ
NATASHA MYRTAJ
Natasha Myrtaj
PROJECTI DREJTIM
KOLAUDIM